



QENDRA
E PROVIMEVE

► GARAT
SHTETËRORE 2026...



UDHËZIME PËR GARUESIT

Garat shtetërore për nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme për vitin shkollor 2025-2026 do të mbahen në IP Shkollën fillore "Vlladimir Nazor" në Podgoricë.

Datat e mbajtjes së garave janë:

Grupi i lëndëve	Lënda	Data e organizimit të garave	Viti/kategoria
GRUPI 2	GJMSBK/GJSHL Gjuhët e huaja (pjesa me shkrim) Programimi	21 shkurt 2026	Shkolla fillore Shkolla e mesme
1 GRUPI I SOCIOLOGJI PJESA ME SHKRIM	Matematikë Fizikë Kimi Biologji Sociologji (pjesa me shkrim)	22 shkurt 2026	Shkolla fillore Shkolla e mesme
3 GRUPI	Histori Gjeografi Sociologji (pjesa me gojë) Filozofi	28 shkurt 2026	Shkolla fillore Shkolla e mesme

Pas pjesës me shkrim të garës nga gjuhët e huaja dhe Sociologjia (shkolla e mesme), në **pjesën me gojë të garës** ftohen garuesit sipas kriterëve të dhëna në Udhëzimin Profesional për Garën Shtetërore të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme.

Pjesa me gojë e garës nga gjuhët e huaja për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme do të mbahet më **1 mars (e diel) 2026**, në ambientet e **Qendrës së Provimeve**.

Listat përfundimtare të garueseve, orari i aktiviteteve, orari i garave dhe Udhëzimet për garuesit janë publikuar në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

I lusim të gjithë pjesëmarrësit e Garave Shtetërore të diturisë që t'u përmbahen rregullave në vazhdim në mënyrë që të mos shkaktohet tollovi në hollin e shkollës para dhe pas fillimit të garave:

- Garuesit duhet të jenë para hyrjes, nga ana e oborrit të shkollës, jo më vonë se një gjysmë ore para fillimit të hapjes së garave;
- Lista e garueseve do të shpallen në tabelën e njoftimeve përballë derës së hyrjes së shkollës.
- Meqenëse gara nga një numër i madh lëndësh do të mbahet në disa hapësira, është e rëndësishme që garuesit në listat e shpallura t'i kushtojnë vëmendje se në cilën klasë janë të caktuar;
- Pasi që të përfundojnë punën, garuesit duhet që në qetësi ta lëshojnë vendin ku janë zhvilluar garat dhe që mos të ndalen në hollin e ndërtesës së shkollës në mënyrë që të mos e pengojnë punën e të tjerëve.

Organizatori i garave, Qendra e Provimeve, me Udhëzimin profesional ka përkufizuar rastet në të cilat garuesi do të diskualifikohet nëse:

- prezantohet rrejshëm;
- shkruan emrin dhe mbiemrin;
- e dëmton shifrën e vet (bar kodin);
- e hap testin para se mësimdhënësi kujdestar jep leje për hapjen e tij;
- përdor mjetet e palejuara gjatë punës (telefonin celular, faqen e mençur të internetit ose ndonjë pajisje tjetër elektronike për transmetimin e informacioneve dhe mjetet individuale të cilat i kanë përkufizuar autorët e testeve);
- i gris fletët nga testi;
- pengon punën.

Garuesit gjatë zhvillimit të detyrave mund të përdorin lapsin grafit, gomën dhe stilolapsin me ngjyrë të kaltër ose të zezë, gjë që do të saktësohet me testin.

Pranohen vetëm përgjigjet e shkruara me stilolaps.

Nuk lejohet përdorimi i stilolapsit i cili mund të fshihet (stilolapsi shkruaj-fshij), si dhe përdorimi i korrektorit.

Në test nuk guxoni të shkruani asgjë tjetër përveç asaj që kërkohet nga detyra/pyetja.

- Garuesve do t'u sigurohet uji dhe çokolatat e vogla.
Nga mjetet, në sallat ku do të mbahet provimi, garuesit mund të kenë me veten vetëm atë që është lejuar në informatorin për lëndën e caktuar
- Garuesit nuk guxojnë të hyjnë nëpër salla ku do të mbahet testimi para se t'i thërras administruesi i testit. Administratori i testit i thërret garuesit një nga një për të hyrë në klasë me qëllim zbatimin e procedurave.
- ***Për shkak të identifikimit në provim garuesi duhet të ketë një dokument personal me fotografi (letërnjoftimin, pasaportën) ose vërtetimin e vërtetuar nga drejtori i shkollës i cili përmban emrin dhe mbiemrin e nxënësit, fotografinë dhe NUMRIN AMË TË QYTETARIT.***
- Administruesit e testit i thërrasin nxënësit para fillimit zyrtar të provimit, me ç' rast kontrollojnë identitetin e nxënësit/es dhe i udhëzojnë që t'i vendosin sendet në vendin e paraparë për to (çantat, xhaketat, telefonat celularë – të kontrollohen nëse janë të fikur, orët e mençura...). Nëse garuesi nuk ka dokument personal dhe nuk gjen mënyrën që ta tregojë gjatë kohëzgjatjes së provimit, mentori ose përfaqësuesi i shkollës me një deklaratë me shkrim garantojnë për identitetin e garuesit.
- Garuesit me rastin e marrjes së librezës së testit e marrin e dhe një shifër e cila ngjitet në ballinën e testit dhe në Formularin e identifikimit. Marrin edhe një letër me informacione të rëndësishme për orarin e aktiviteteve të Garave shtetërore me një vërejtje që ta përshkruajnë shifrën e vet në drejtkëndëshin e specifikuar. Shifra duhet të përshkruhet sepse në bazë të sajë garuesit kontrollojnë rezultatet të cilat publikohen në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.
- Libreza e testit nuk guxon të hapet para fillimit zyrtar të provimit!
- Kur të gjithë garuesit të zënë vendet e veta, administruesi i testit do ta lexojë tekstin me udhëzimet e shkurtra.
- Pas leximit të tekstit administruesi i testit u jep shenjën garuesve që mund të fillojnë me zgjidhjen e testit.
- Gjatë provimit garuesit i lejohet shfrytëzimi i mjeteve që parashikohen e që janë theksuar për lëndët e caktuara në librezën e testit.
- Gjatë garës nuk lejohet dalja nga salla në 120 minutat e para. Pas kësaj, garuesi ka të drejtë të largohet nga salla vetëm njëherë, i shoqëruar nga administratori i testit, për jo më shumë se 3 minuta.
- Nëse garuesi përfundon zgjidhjen e testit para kohës, mund ta dorëzojë librezën e testit dhe të largohet nga salla ku mbahet provimi dhe ndërtesa e shkollës duke mos penguar punën e garueseve të tjerë.
- Administruesit e testit 15 minuta para përfundimit të kohës së paraparë për zhvillimin e testit do t'i njoftojnë garuesit se po afrohet koha e përfundimit të provimit.
- Kur e përfundon punën garuesi e dorëzon testin, nënshkruhet në Formularin e identifikimit dhe së bashku me administruesin e testit përsëri e kontrollon shifrën.
- Pas zhvillimit të detyrave (testeve), Qendra e Provimeve publikon përmbajtjen e testeve dhe zgjidhjet e të gjitha detyrave në faqen e internetit.

Administruesit e testit garueseve do t'ju japin udhëzime teknike lidhur me punën. Nuk u lejohet që të japin sqarime lidhur me detyrat/pyetjet në test. Nëse garuesi ka ndonjë koment

ose paqartësi mund t'i shënojë ato pranë detyrës konkrete ose në fund të testit. Nëse komenti është i arsyeshëm autori/vlerësuesi do ta marr parasysht atë me rastin e kontrollimit të testit.

Detyrat/pyetjet në teste nuk është e thënë që të zhvillohen me atë renditje ashtu si janë dhënë. Nëse ndonjë detyrë është shumë e vështirë, garuesi nuk ka nevojë që të ndalet në të, por mund të kalojë në detyrën e radhës. Nëse ju mbetet kohë, më së miri është që ta shfrytëzoni duke provuar që t'i zgjidhni detyrat të cilat nuk i keni zgjidhur më parë ose të kontrolloni ato që janë zhvilluar. Puna në test bëhet e pavarur, sepse nuk lejohet asnjë lloj marrëveshjeje. Duhet të shkruani lexueshëm. Gjatë punës mund të shfrytëzoni lapsin grafit, ***mirëpo vlerësuesit do të vlerësojnë vetëm përgjigjet e shkruara me stilolaps.***

INFORMACIONET TË CILAT PASOJNË DHE NDONJË UDHËZIM TJETËR TË DOBISHËM DO T'I GJENI NË FILLIM TË ÇDO TESTI. JU LUTEM QË T'I LEXONI ME KUJDES DHE T'U PËRMBAHENI ME PËRPIKËRI.

GJUHË DHE LETËRSI MALAZEZE-SERBE, BOSHNJAKE, KROATE / GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KOHËZGJATJA E TESTIT

Klasa e gjashtë: 90 minuta

Klasa e nëntë: 90 minuta

Klasa e parë dhe e dytë e shkollës së mesme: 120 minuta

Klasa e tretë dhe e katërt e shkollës së mesme: 120 minuta

Mjetet e lejuara për punë: janë lapsi, goma dhe stilolapsi me ngjyrë të kaltër ose të zezë.

Nuk lejohet përdorimi i: stilolapsit shkruaj-fshij, telefonave celularë dhe çdo pajisjeje tjetër elektronike.

Lapsin grafit mund ta përdorni gjatë punës, por **PËRGJIGJJA PËRFUNDIMTARE DUHET TË SHKRUHET ME STILOLAPS.**

Shkruani lexueshëm në gjuhën standarde!

Mund të shkruani me shkronja dore ose shtypi (nëse shkruani me shkronja shtypi theksoni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë).

Nëse gaboni, fshijeni apo vendosni një vijë mbi përgjigjen e gabuar dhe përgjigjuni/rrethoni përgjigjen përsëri.

Punoni në mënyrë të pavarur. Nuk lejohet asnjë marrëveshje me të tjerët.

Nëse nuk mund ta zgjidhni menjëherë një pyetje/detyrë, kaloni tek tjetra në vazhdim. Nëse ju mbetet kohë, mund të ktheheni më vonë tek pyetjet e vështira.

Vlerësimi me pikë:

FUSHAT	GJUHË	LETËRSI
Numri maksimal i pikëve	50	50

Informatorët për garën nga Gjuha dhe Letërsia Malazeze-Serbe, Boshnjake, Kroate dhe Gjuha Shqipe dhe Letërsia gjenden në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve

GJUHËT E HUAJA

Garat shtetërore nga gjuhët e huaja përfshijnë dy pjesë: pjesën e provimit me gojë dhe me shkrim.

Kohën të cilën nxënësit e kanë në dispozicion për zgjidhjen e pjesës së testit me shkrim është 90 minuta për nxënësit e shkollës fillore, kurse 150 minuta për nxënësit e shkollës së mesme. Numri maksimal i pikëve në pjesën e provimit me shkrim është 100.

Shuma e rezultateve të arritura në pjesën me shkrim dhe me gojë të provimit paraqet numrin e përgjithshëm të pikëve të fituara në bazë të të cilave formohet rang lista përfundimtare dhe përcaktohen fituesit.

FUSHA	NUMRI I DETYRËS	TIPI I DETYRËS	NUMRI I PIKËVE
1. Të dëgjuarit	1-2 tekste	<ul style="list-style-type: none">• me zgjedhje të shumëfishtë• me zgjedhje alternative• me përgjigje të shkurtër• me lidhje• me plotësim	20
2. Të lexuarit	2 tekste	<ul style="list-style-type: none">• me zgjedhje të shumëfishtë• me zgjedhje alternative• me lidhje• me radhitje• me përgjigje të shkurtër• me plotësim• me vendosje	25
3. Përdorimi i gjuhës (Gramatika dhe leksiku)	rreth 20-25 pyetje	<ul style="list-style-type: none">• me zgjedhje të shumëfishtë• me plotësim• me transformimin e fjalive• me formimin e fjalëve	25
4. Të shkruarit	1 ese	Shkolla fillore – shkrimi i hartimit (120-150 fjalë) Shkolla e mesme <ul style="list-style-type: none">• shkrimi i hartimit FR, IT, GJ, RU: 150-200 fjalë për vitin e 1-rë dhe të 2-të. 180-250 fjalë për vitin e 3-të dhe të 4-ët.• ANG: 200-300 fjalë	30
5. Të folurit	3 detyra	<ul style="list-style-type: none">• prezantimi• bashkëveprimi i të folurit• ekspozimi	20

Në detyra mund të kërkohet edhe aftësia e zbatimit të njohurive në situata të reja. Mjetet e lejuara janë stilolapsi me ngjyrë të kaltër ose të zezë. Nëse gaboni, vendosni një vijë të kryqëzuar mbi zgjidhjen e gabuar dhe përgjigjuni sërish. Gjatë kohës së punës në test **nuk lejohet përdorimi i fjalorit**.

Nëse ndonjë pyetje/detyrë nuk mund ta zgjidhni menjëherë, kaloni në tjetrën në vazhdim. Nëse ju mbetet kohë, mund të riktheheni përsëri në pyetje të tilla.

Informatori për garën nga gjuhët e huaja gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

MATEMATIKA

Gjatë zhvillimit të detyrave mund të përdoren veglat gjeometrike, lapsi grafit, goma dhe stilolapsi me ngjyrë të kaltër ose të zezë. Nuk lejohet përdorimi i kalkulatorit, telefonave celularë dhe mjeteve tjera elektronike.

Është e nevojshme që zgjidhjet e detyrave të argumentohen hollësisht dhe të shkruhen me stilolaps.

Informatori për garën nga Matematika gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

BIOLOGJIA

Janë paraparë 120 minuta për zgjidhjen e testit për të tri kategoritë e garave.

Në tekst është dhënë tabela me numrin e paraparë të pikëve për çdo detyrë. Gjithashtu është dhënë edhe udhëzimi në vazhdim për zhvillimin e testit dhe rregullat e sjelljes:

- Testin **detyrimisht** duhet punuar me stilolaps me ngjyrë të kaltër ose të zezë (lapsin grafit mund ta përdorni gjatë punës, por përgjigjja përfundimtare duhet të jetë e shkruar me laps kimik).
- Nëse gaboni, vendosni një vijë të kryqëzuar mbi zgjidhjen e gabuar dhe përgjigjuni përsëri.

Informatori për garën nga Biologjia gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

KIMIA

Koha e paraparë për zhvillimin e testit është:

Shkolla fillore 120 minuta;
Shkolla e mesme, kategoria 1 dhe 2 – 150 minuta;
Shkolla e mesme kategoria 3 dhe 4 – 180 minuta.

Në test është dhënë tabela me numrin e planifikuar të pikëve për çdo detyrë. Gjithashtu, është dhënë edhe udhëzimi në vazhdim për zhvillimin e testit dhe rregullat e sjelljes:

- Testi detyrimisht të punohet me stilolaps me ngjyrë të kaltër ose të zezë
- Mund të përdorni llogaritësin/kalkulatorin elektronik.

Përgjigjet dhe ecuritë e punës të cilat nuk janë shkruar me laps kimik nuk do të kontrollohen.

Nëse gaboni, vendosni një vijë të kryqëzuar mbi zgjidhjen e gabuar dhe përgjigjuni përsëri.

Informatori për garën nga Kimia gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

FIZIKA

Koha e paraparë për zhvillimin e testit është:

Shkolla fillore - 150 minuta;

Shkolla e mesme, të dy kategoritë – 180 minuta.

Testin **detyrimisht** duhet punuar me stilolaps me ngjyrë të kaltër ose të zezë.

Mund të përdorni veglat gjeometrike dhe kalkulatorin. Pranohen vetëm përgjigjet e shkruara me stilolaps.

Çdo formulë e shkruar saktë, skicë e vizatuar ose përfundim që ka të bëjë me zgjidhjen e detyrës vlerësohet sipas kriterit unik.

I lusim garuesit që zgjidhjet e tyre dhe komentet t'i shkruajnë dukshëm dhe qartë, që t'i numërtojnë formulat të cilat i përdorin me rastin e përfutimit, në mënyrë që vlerësuesit lehtë dhe shpejt të përcjellin ecurinë e zgjidhjeve të tyre.

Me rastin e zgjidhjeve të detyrave domosdo duhet të përdoren shenjat e dhëna në formulimin e detyrës.

Është e dëshirueshme që me rastin e zgjidhjes së detyrave të gjitha të ilustrohen me vizatimin përkatës, në të cilin tregohen madhësitë fizike relevante (shpejtësia, forca, distanca, ...)

Detyrat duhet zgjidhur ashtu që të fitohet shprehja përfundimtare analitike e madhësisë së kërkuar fizike në funksion nga madhësitë e dhëna në formulimin e detyrës. Nëse kjo kërkohet me detyrë, llogarit vlerën numerike, për të cilën mund të përdoret një kalkulator i xhepit.

Informatori për garën nga Fizika gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

GJEOGRAFIA

Testi plotësohet vetëm me stilolaps me ngjyrë të kaltër ose të zezë. Pranohen përgjigjet e shkruara me stilolaps. Nëse gaboni, vendosni një vijë të kryqëzuar mbi përgjigjen e gabuar dhe përgjigjuni përsëri

Testi për Gara Shtetërore nga gjeografia për shkollën e mesme përbëhet nga dy pjesë, nga:

- Testi multimedial – që zgjatë 20 deri në 60 minuta, koha konkrete do të caktohet në test
- Testi me shkrim – që zgjatë nga 60 - 90 minuta, koha konkrete do të caktohet në test

Testi multimedial punohet në bazë të sllajdeve të cilët u shfaqen garuesve. Koha për përgjigje është e kufizuar me kohëzgjatjen e sllajdit për një pyetje të caktuar. Pyetjet zgjidhen një pas tjetrës dhe nuk ka kthim në pyetjen e mëparshme. ***Nxënësit japin përgjigje në fletën e përgjigjeve.*** Testi multimedial përbëhet nga 20 deri në 30 pyetje, secila pyetje përbëhet nga harta dhe/ose pamja, filmi ose grafiku dhe pyetja e shkurtër. Pyetja është me zgjedhje të shumëfishtë me 4 opsione të përgjigjes, nga i cili një është i saktë.

Në tekstin e shkruar, në librezën e testit garuesit përgjigjen në pyetje nga testi klasik. Zgjidhja e detyrës mund të jetë një përgjigje e shkurtër, shpjegim ose analizë e tabelës, hartës ose interpretimi apo shpjegimi i të dhënave nga tabela. Nuk e keni për detyrë të përgjigjeni në

pyetje sipas radhës që janë dhënë në test. Përgjigjet në disa detyra nuk janë të kufizuara për nga koha.

Për garat shtetërore nga gjeografia për shkollën fillore bëhet një test në formën e testit klasik me shkrim.

Për zhvillimin e testit janë planifikuar 90 minuta.

Testi plotësohet ekskluzivisht me një stilolaps me ngjyrë të kaltër ose të zezë. Pranohen vetëm përgjigjet e shkruara me stilolaps. Nëse gaboni, vendosni një vijë të kryqëzuar mbi përgjigjen e gabuar dhe përgjigjuni përsëri.

Nuk lejohet përdorimi i korrektorit, lapsave kimikë me fshirje, telefonave celularë dhe asnjë pajisjeje tjetër elektronike.

Informatori për garën nga Gjeografia gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

HISTORIA

Për zhvillimin e testit janë paraparë 90 minuta.

Testi plotësohet ***detyrimisht*** me stilolaps me ngjyrë të kaltër ose të zezë. Pranohen vetëm përgjigjet e shkruara me stilolaps. Nëse gaboni, vendosni një vijë të kryqëzuar mbi përgjigjen e dhënë dhe përgjigjuni përsëri.

Nuk lejohet përdorimi i korrektorit, lapsave kimikë me fshirje, telefonave celularë dhe asnjë pajisjeje tjetër elektronike.

Informatori për garën nga Historia gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

FILOZOFIA

Garat Shtetërore nga Filozofia përbëhen nga shkrimi i esesë filozofik në gjuhën angleze.

Garuesit mund të përdorin vetëm fjalorët një gjuhësor.

Shkrimi i esesë zgjatë 120 minuta dhe shkruhet në kompjuter. Në kompjuter paraprakisht do të vendoset ballina e dokumentit në Word në të cilin nxënësit/nxënëset do të shkruajnë esenë.

Udhëzimet për garuesit:

- Punën tuaj në kompjuter e ruani me shifrën e cila do t'ju ndahet (duhet ta riemëroni dokumentin e dhënë).
- Kur ta hapni dokumentin, në faqen e parë shkruani shifrën tuaj në vendin e paraparë për të.
- Në dokument do të cekën të gjitha temat e ofruara dhe **çdo garues zgjedh një temë për të cilën dëshiron të shkruaj esenë.**
- Bartni numrin rendor të temës në vendin e paraparë për të **(TOPIC NO.)**
- Kur ta hapni dokumentin word dhe të vendosni shifrën tuaj, kyçni opsionin auto-correct.

Për shkrimin e konceptit, para fillimit të garës do të fitoni disa fletë të[pastra, të formatit A4, me vulë të Qendrës së Provimeve.

Garuesit fletët e konceptit nuk i qesin jashtë sallës së provimit.

Informatori për garën nga Filozofia gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

SOCIOLOGJIA

Garat Shtetërore nga Sociologjia përbëhen nga dy pjesë:

1. Garat në formë të shkrimit. Numri maksimal i pikëve është 100. Kohëzgjatja e pjesës me shkrim është 180 minuta.
2. Pjesa me gojë e cila nënkupton prezantimin e esesë para Komisionit me përgjigje në pyetjet e mundshme. Numri maksimal i pikëve është 20.

Garat në formë të shkrimit përmbajnë pyetje të tipit të mbyllur dhe të hapur që kanë të bëjnë me fushat e dhëna të lëndës së sociologjisë duke përfshirë këtu edhe **shkrimin e esesë si përgjigje në temën e dhënë.**

Tema e esesë caktohet ashtu që në fillim të shkrimit të pjesës me shkrim të garës tërhiqet publikisht një nga 5 temat e përgatitura:

1. Në librezën e testit janë dhënë të gjitha temat e ofruara për shkrimin e esesë.
2. Qendra e Provimeve do të përgatis zarfin me fletat në të cilat janë temat e dhëna.
3. Kur garuesit të zënë vendet e tyre dhe të marrin librezën e testit të cilën ende nuk guxojnë ta hapin, fillon tërheqja publike e temës për ese.
4. Administruesi i testit e hap zarfin para nxënësve dhe e tërheq një fletë dhe e lexon numrin rendor dhe emrin e temës që është tërhequr.
5. Garuesve u tregon edhe fletat tjera me tema.

Testi plotësohet vetëm me stilolaps (me ngjyrë të kaltër ose të zezë).

Në herë e shkruar ose e rrethuar përgjigjja mund të përmirësohet, ashtu që do të anulohet me shenjën X dhe do të rrethohet një përgjigje tjetër e cila mendohet se është e saktë.

Eseja në temën e dhënë mund të ketë deri në 500 fjalë me një tolerancë të tejkalimit më së shumti deri në 10%. Numri i fjalëve në kornizën e dhënë nuk është vendimtar për vlerësimin e cilësisë së esesë.

Në rast të shkeljes së normave morale dhe devijimit drastik nga forma letrare duke përdorur gjuhën e urrejtjes dhe të ngjashme, eseja nuk do të vlerësohet dhe studenti do të diskualifikohet.

Informatori për garën nga Sociologjia gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

PROGRAMIMI

Gara përbëhet nga zgjidhja e 3 detyrave problemore.

Koha e paraparë për punë është:

Për shkollat fillore – 3 orë (180 minuta);

Për shkollat e mesme – 4 orë (240 minuta).

Detyrat duhet të zgjidhen me një nga gjuhët e programit në vazhdim: Pascal, C, C++ ose Java. Garuesit të cilët përdorin Pascal duhet të programojnë në **FreePascal**. Garuesit në C-u ose C++-duhet të shfrytëzojnë veglat e programit **CodeBlocks**. Për gjuhën programore Java është paraparë përdorimi i platformës **Eclipse**. Është e lejueshme që të përdoret editor i sipas zgjedhjes dhe me ndihmën e veglave të dhëna të përkthehet kodi burimor në fajllin ekzekutiv.

Gjatë garave **nuk guxoni të komunikoni** me asnjë person, përveç me personin kujdestar të garave. Kjo do të thotë se duhet **të punoni në mënyrë të pavarur dhe nuk guxoni të përdorni internetin**. Gjithashtu është e ndaluar të përdoret ndonjë program i shkruar më parë ose pjesë të programit.

Pas skadimit të kohës së paraparë për gara, në desktop në folderin me emrin „**Vaša šifra**“ - **Për shkollat fillore** i „**Takmičenje 2026**“ - **Për shkollat e mesme** duhet të gjenden fajllat me zgjidhjet e kodeve burimore të incizuara. Zgjidhjet tuaja mund t'i upload-oni në sistemin e garave, nëse është i qasshëm, dhe mund të vërtetoni se sa pikë keni fituar. Pas garave, komisioni do të testojë zgjidhjet tuaja edhe një herë. Në fund të çdo detyre janë dhënë shembujt e të dhënave të testit. Ata shembuj shërbejnë që ta keni sa më të qartë tekstin e detyrës dhe për kontrollimin e formatit të hyrjes dhe të daljes, dhe nuk shërbejnë për kontrollimin e saktësisë së programit tuaj. Nëse programi juaj punon në ata shembuj, ajo **nuk është një garanci** se do të punojë në të dhënat zyrtare për testim.

Numri i përgjithshëm i pikëve në një detyrë është i barabartë me shumën e pikëve të të dhënave të testit që përkojnë me zgjidhjen zyrtare. Numri i përgjithshëm i pikëve është i barabartë me shumën e pikëve në të gjitha detyrat.

VËREJTJE PËR SHKOLLËN E MESME: Të gjitha informacionet e detyrave (emrin e detyrës, hyrjen, daljen, kufizimin kohor dhe të kujtesës, mënyrën e vlerësimit me pikë) mund t'i gjeni në faqen hyrëse me titullin Detyrat.

Nëse keni diçka të paqartë për mënyrën e organizimit të kësaj garave, menjëherë bëni pyetje tek kujdestari që t'ju sqarojë. Gjatë gjithë garës, mund t'i bëni pyetje personit kujdestar që t'ju japë sqarime për detyrat. Lejohen pyetjet që sqarojnë paqartësitë në tekstin e detyrës.

Nuk ju lejohe të bëni pyetje në lidhje me zgjidhjen e detyrave. Përpara se të bëni një pyetje, lexojeni sërish detyrën, pasi që mund ta keni anashkaluar një pjesë të detyrës në leximin e mëparshëm.

Mosrespektimi i këtyre rregullave ose mos përmbajtja e formatit të të dhënave dalëse do të rezultojë në humbje të pakthyeshme të pikëve. Mos printoni asgjë që nuk kërkohet në detyrë, si për shembull mesazhet e tipit "Zgjidhja është:" ose "Vendosni numrat" dhe të ngjashme!

Me fat dhe gara të suksesshme!

E RËNDËSISHME për gjuhën Java!

Mos krijoni paketa për detyrat tuaja, por përdorni paketën e nënkuptuar (default). Informatori për garën nga Programimi gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve.

SHKOLLA FILLORE

ORARI I AKTIVITETEVE

Garat, publikimi i testeve dhe zgjidhjeve pas garave në faqen e internetit të QP-së	Rezultatet preliminare në faqen e internetit të QP-së	Shikimi i testeve dhe paraqitja e ankesave	Përgjigjet në ankesa, rezultatet përfundimtare – publikimi në faqen e internetit të QP-së
<p>2. GRUPI I LËNDËVE E shtunë, më 21 shkurt 2026</p> <p>1. GRUPI I LËNDËVE E diel, më 22 shkurt 2026</p>	<p style="text-align: center;">E martë, më 24 shkurt 2026</p>	<p>Shikimi i testit: e mërkurë, më 25 shkurt 2026, prej orës 10 deri në orën 14 në ambientet e QP-së</p> <p>Ankesat: deri të mërkurën, më 25 shkurt 2026, deri në orën 15 në e-mailn: takmicenje.os@iccg.edu.me</p>	<p style="text-align: center;">E premte, më 27 shkurt 2026</p>
<p>3. GRUPI I LËNDËVE E shtunë, më 28 shkurt 2026</p>	<p style="text-align: center;">E martë, më 3 mars 2026</p>	<p>Shikimi i testit: e mërkurë, më 4 mars 2026, prej orës 10 deri në orën 14 në ambientet e QP-së</p> <p>Ankesat: deri të mërkurën, më 4 mars 2026, deri në orën 15 në e-mailn: takmicenje.os@iccg.edu.me</p>	<p style="text-align: center;">E premte, më 6 mars 2026</p>
<p>ME GOJË NGA GHUHËT E HUAJA</p> <p>E diel, më 1 mars 2026 në ambientet e QP-së në orën 10.30</p>	<p style="text-align: center;">E hënë, më 2 mars 2026</p>	<p>Shikimi i testit: e martë, më 3 mars 2026, prej orës 10 deri në orën 12 në ambientet e QP-së</p> <p>Ankesat: deri të martën, më 3 mars 2026, deri në orën 13 në e-mailin takmicenje.os@iccg.edu.me</p>	<p style="text-align: center;">E mërkurë, më 4 mars 2026</p>

SHKOLLA E MESME

ORARI I AKTIVITETEVE

Garat, publikimi i testeve dhe zgjidhjeve pas garave në faqen e internetit të QP-së	Rezultatet preliminare në faqen e internetit të QP-së	Shikimi i testeve dhe paraqitja e ankesave	Përgjigjet në ankesa, rezultatet përfundimtare – publikimi në faqen e internetit të QP-së
<p>2. GRUPI I LËNDËVE E shtunë, më 21 shkurt 2026</p> <p>1. GRUPI I LËNDËVE DHE PJESA ME SHKRIM NGA SOCIOLOGJIA E diel, më 22 shkurt 2026</p>	<p>E martë, më 24 shkurt 2026</p>	<p>Shikimi i testit: e mërkurë, më 25 shkurt 2026, prej orës 10 deri në orën 14 në ambientet e QP-së</p> <p>Ankesat: deri të mërkurën, më 25 shkurt 2026, deri në orën 15 në e-mail: takmicenje.os@iccg.edu.me</p>	<p>E premte, më 27 shkurt 2026</p>
<p>3. GRUPI I LËNDËVE DHE PJESA ME GOJË[NGA SOCIOLOGJIA E shtunë, më 28 shkurt 2026</p>	<p>E martë, më 3 mars 2026</p>	<p>Shikimi i testit: e mërkurë, më 4 mars 2026, prej orës 10 deri në orën 14 në ambientet e QP-së</p> <p>Ankesat: deri të mërkurën, më 4 mars 2026, deri në orën 15 në e-mail: takmicenje.os@iccg.edu.me</p>	<p>E premte, më 6 mars 2026</p>
<p>ME GOJË NGA GHUHËT E HUAJA</p> <p>E diel, më 1 mars 2026 në ambientet e QP-së në orën:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 13.00 klasa 1 dhe 2 ▪ 15.30 klasa 3 dhe 4 	<p>E hënë, më 2 mars 2026</p>	<p>Shikimi i testit: e martë, më 3 mars 2026, prej orës 10 deri në orën 12 në ambientet e QP-së</p> <p>Ankesat: deri të martën, më 3 mars 2026, deri në orën 13 në e-mailin takmicenje.os@iccg.edu.me</p>	<p>E mërkurë, më 4 mars 2026</p>